



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 nëntor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit

T'i njoftohet:

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	4
III.	ASPEKTE PARAPRAKE	5
IV.	UDHËZIME	5
A.	Paraqitja e të akuzuarve në gjykim	5
B.	Rendi i paraqitjes së provave	6
C.	Kohëzgjatja e paraqitjes së provave	7
1.	Caktimi i kohës për ZPS-në	7
2.	Caktimi i kohës për Mbrojtjen	8
D.	Blloqet e dëshmimeve dhe rendi i paraqitjes së dëshmitarëve	8
E.	Përdorimi efikas i kohës në sallën e gjyqit	10
F.	Marrja në pyetje me videokonferencë dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve jashtë vendit ku mbahet gjykimi	11
G.	Masat mbrojtëse në gjykatë dhe masat e posaçme	13
H.	rendi dhe forma e marrjes në pyetje të dëshmitarëve	13
I.	Përdorimi i materialeve gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve	16
J.	Procesi ublik dhe përdorimi i seancave private dhe/ose të mbyllura	20
K.	Redaktimet gjatë seancave	21
L.	Vetinkriminimi i dëshmitarit	22
M.	Dëshmitarët ekspertë	23
N.	Rregullat 153-155 të Rregullores	24
O.	Fakte të pranuar nga palët	24
P.	Faktet e njohura nga gjithkush	24
Q.	Parashtrimet lidhur me procedurën e përcaktimit të dënimit	24
R.	Dorëzimi i parashtrimeve të protokolluara	25
S.	Riklasifikimi i parashtrimeve të protokolluara dhe transkripteve	26
T.	Komunikimi me Trupin Gjykses	28
V.	VENDIM	28

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) merr këtë vendim mbi zhvillimin e gjykimit .

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 shtator 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues.¹
2. Më 24 shtator 2024, Trupi Gjykues kërkoi parashtrime nga palët në lidhje me, ndër të tjera, aspekte që lidhen me zhvillimin e procesit (Vendimi mbi Konferencat Përgatitore për Gjykimin).²
3. Nga 28 shtatori deri në 2 tetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS),³ Mbrojtja e Haxhi Shalës (Mbrojtja e Shalës),⁴ Mbrojtja e Sabit Januzit (Mbrojtja e

¹ KSC-BC-2023-10, F00468, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Transmitting the Case File to Trial Panel I](#) (Vendim për Kalimin e Çështjes Trupit Gjykues), 4 shtator 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike. *Shih gjithashtu* F00466, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, [Decision Assigning Trial Panel I](#) (Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues I), 3 shtator 2024, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00479, Trupi Gjykues I, [Decision setting the dates for trial preparation conferences, requesting submissions and on related matters](#) (Vendim për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin, Parashtrime nga Palët dhe Çështje të Lidhura me Të), 24 shtator 2024, publik, para. 12, 32(c).

³ KSC-BC-2023-10, F00491, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë përpara Konferencave Përgatitore për Gjykimin* (Parashtrimet e ZPS-së), 1 tetor 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 4 tetor 2024, F00491/RED.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00482, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrim prej Mbrojtjes së Haxhi Shalës i Informacionit me Shkrim sipas Specifikimeve në Paragrafët 12-20 të Vendimit F00479*, 28 shtator 2024, publik, me Shtojcën 1, publike.

Januzit),⁵ Mbrojtja e Ismet Bahtijarit (Mbrojtja e Bahtijarit),⁶ (bashkërisht, të akuzuarit dhe Mbrojtja), dhe Zyra Administrative⁷ paraqitën parashtrimet e tyre.

4. Më 7 dhe 8 tetor 2024, Trupi Gjykses mbajti konferenca përgatitore për gjykimin, ku palët dhe Zyra Administrative bënë parashtrime të mëtejshme.⁸

5. Më 17 tetor 2024, pas udhëzimeve të mëtejshme të Trupit Gjykses,⁹ Mbrojtja e Shalës dorëzoi parashtrime shtesë në lidhje me, ndër të tjera, një propozim të bërë nga ZPS-ja¹⁰ në lidhje me kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit (Parashtrimet Shtesë të Shalës).¹¹

6. Më 18 tetor 2024, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për pranimin e provave të dy dëshmitarëve sipas rregullës 154 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, Rregullorja dhe Mocioni sipas Rregullës 154)¹²

⁵ KSC-BC-2023-10, F00495, Mbrojtja e Januzit, *Parashtrime në emër të Januzit për Konferencat Përgatitore për Gjykimin*, 2 tetor 2024, publike.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00494, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të BAHTIJARIT mbi Përgatitjen e Gjyimit sipas Vendimit F00479*, 2 tetor 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 18 tetor 2024, F00494/RED. Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Bahtijarit për zgjatjen e afatit të dorëzimit të parashtrimeve të saj, *shih* CRSPD79, *Udhëzim i Kryegjykatëses së Trupit Gjykses I*, 30 shtator 2024, konfidencial.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00490, Zyra Administrative, *Parashtrime të Zyrës Administrative për Konferencat Përgatitore për Gjykimin*, 1 tetor 2024, publike, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe Shtojcat 2 deri 5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 7 tetor 2024, konfidencial, f. 279-360; Transkripti i seancës, 8 tetor 2024, konfidencial, f. 361-377.

⁹ *Shih* KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 8 tetor 2024, publik, f. 368, rreshtat 11-22.

¹⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 40-41.

¹¹ KSC-BC-2023-10, F00539, Mbrojtja e Shalës, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Ndryshme të Bëra nga ZPS-ja për Konferencën Përgatitore për Gjykimin*, 17 tetor 2024, konfidenciale, para. 14.

¹² KSC-BC-2023-10, F00540, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarit 1 dhe W04891-shit sipas Rregullës 154*, 18 tetor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 23 tetor 2024, F00540/RED.

7. Më 24 tetor 2024, Trupi Gjykses caktoi 14 nëntorin 2024 si datë të fillimit të gjykimit, dha udhëzime në lidhje me deklaratat hyrëse dhe caktoi 9 dhjetorin 2024 si datë për fillimin e paraqitjes së provave.¹³
8. Më 5 nëntor 2024, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Prokurores së Specializuar për Pranimin e Provave të Dëshmitarit 1 dhe W04891-shit sipas Rregullës 154, me të cilin rrëzoi Mocionin sipas Rregullës 154.¹⁴
9. Ndërmjet datave 4 dhe 6 nëntor 2024, ekipet e Mbrojtjes dorëzuan listat përkatëse të dëshmitarëve të tyre.¹⁵
10. Më 6 nëntor 2024, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave Jogojore (Vendimi Kornizë mbi Provat).¹⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Trupi Gjykses mban parasysh nenet 21(2) dhe 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 82, 84(1), 104(1), 116, 120, 127, 141, 143-146, 149, 151 dhe 153-157 të Rregullores.

¹³ KSC-BC-2023-10, F00559, Trupi Gjykses I, [*Decision on the date for the commencement of the trial*](#) (Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit), 24 tetor 2024, publik, para. 17.

¹⁴ KSC-BC-2023-10, F00580, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin e Prokurores së Specializuar për Pranimin e Provave të Dëshmitarit 1 dhe W04891-shit sipas Rregullës 154*, 5 nëntor 2024, publik, para. 18(a).

¹⁵ KSC-BC-2023-10, F00576, Mbrojtja e Bahtijarit, *Lista e Dëshmitarëve të BAHTIJARIT dhe Njoftim për Dëshmitë e Dëshmitarëve Ekspertë*, 4 nëntor 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2024, F00576/RED; F00578, Mbrojtja e Januzit, *Lista e Dëshmitarëve të Januzit*, 4 nëntor 2024, konfidenciale; F00581, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrim prej Haxhi Shalës i Listës së Dëshmitarëve dhe Informacionit në lidhje me Të*, 6 nëntor 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

¹⁶ KSC-BC-2023-10, F00583, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave Jogojore*, 6 nëntor 2024, publik.

III. ASPEKTE PARAPRAKE

12. Trupi Gjykues rikujton se ka hedhur poshtë Parashtrimet Shtesë të Shalës si të dorëzuara jashtë afatit.¹⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do t'i marrë parasysh ato në kuadër të këtij vendimi.

IV. UDHËZIME

13. Sa vijon, janë udhëzimet fillestare të Trupit Gjykues mbi zhvillimin e gjykimit. Aspektet që nuk trajtohen në këtë vendim e të cilat kërkojnë ndërhyrje nga Trupi Gjykues, do të trajtohen gjatë zhvillimit të gjykimit. Në përgjithësi, Trupi Gjykues nuk ka trajtuar aspektet e rregulluara tashmë në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHS) ose në udhëzuesit përkatës të punës dhe udhëzimet e Zyrës Administrative.

A. PARAQITJA E TË AKUZUARVE NË GJYKIM

14. Nëse një i akuzuar ka ndër mend të mos jetë pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit, ekipet përkatëse të Mbrojtjes, urdhërohen të informojnë me postë elektronike për këtë Trupin Gjykues, ZPS-në, Zyrën Administrative dhe ekipet e tjera të Mbrojtjes, përmes Njësisë për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ), të paktën dy (2) ditë pune para fillimit të seancës. Sa u përket seancave që fillojnë të hënave, ekipet përkatëse të Mbrojtjes, urdhërohen të njoftojnë për këtë më së voni deri në orën 9:30 të së enjtes pararendëse. Në rastin e seancave që fillojnë ditën e martë, ekipet përkatëse të Mbrojtjes, urdhërohen të njoftojnë më së voni deri në orën 09:30 të së premtes pararendëse. Trupi Gjykues thekson se vetëm në rast të një sëmundjeje të paparashikueshme në ditën kur është caktuar seanca, të akuzuarit do t'i lejohet, si

¹⁷ Vendimi Kornizë mbi Provat, para. 8-9.

përfashtim, të marrë pjesë në proces përmes videolidhjes nga objekti i paraburgimit, pa njoftuar paraprakisht të paktën dy (2) ditë pune më herët.

15. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se pjesëmarrja përmes videolidhjes nga objekti i paraburgimit ose nga brenda ambienteve të DHS-së, nuk dëmton të akuzuarit, pasi ata do të mund ta ndjekin procesin dhe të komunikojnë me mbrojtësit e tyre, të cilët do të jenë të pranishëm në sallën e gjyqit. Këto udhëzime nuk cenojnë kompetencën e Trupit Gjykses për të urdhëruar të akuzuarit të jenë të pranishëm në çdo seancë kur Trupi Gjykses e konsideron të domosdoshme praninë fizike të tyre, ose kur kjo kërkohet sipas Rregullores.

16. Zyra Administrative merr të gjitha masat e nevojshme për të organizuar videolidhjen dhe një linjë të drejtpërdrejtë komunikimi ndërmjet të akuzuarit dhe mbrojtësit në sallën e gjyqit.

B. RENDI I PARAQITJES SË PROVAVE

17. Në bazë të rregullës 127(2) të Rregullores, provat në gjykim paraqiten sipas kësaj renditjeje:

- (i) prova të ZPS-së;
- (ii) prova të Mbrojtjes;
- (iii) prova të kërkuara nga Trupi Gjykses sipas rregullës 132 të Rregullores, nëse ka;
- (iv) me autorizim të Trupit Gjykses, kundërprova të Prokurorit të Specializuar; dhe
- (v) me autorizim të Trupit Gjykses, kundërprova të Mbrojtjes.

18. Trupi Gjykses rikujton se ka ftuar Mbrojtjen të angazhohet në komunikime *inter partes* për të vendosur me marrëveshje rendin e paraqitjes së provave përkatëse

të tyre.¹⁸ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen të njoftojë Trupin Gjykses nëse marrëveshja është arritur më së voni deri **të martën, 17 dhjetor 2024, në orën 16:00.**

C. KOHËZGJATJA E PARAQITJES SË PROVAVE

19. Udhëzimet e mëposhtme kanë të bëjnë me paraqitjen e provave të ZPS-së. Trupi Gjykses do të lëshojë udhëzime në lidhje me paraqitjen e provave nga Mbrojtja në një fazë të mëvonshme të procesit.

1. Caktimi i kohës për ZPS-në

20. ZPS-ja ka bërë të ditur se synon të mbështetet në dy dëshmitarë në gjykim, deklaratat e mëhershme me shkrim të të cilëve kërkon t'i paraqesë sipas rregullës 154.¹⁹ ZPS-ja vlerësoi se do t'i duhen 6 orë për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të saj në qoftë se miratohet Mocioni sipas Rregullës 154,²⁰ dhe 12 orë në qoftë se Mocioni nuk miratohet.²¹

21. Duke marrë parasysh vendimin e Trupit Gjykses për rrëzimin e Mocionit sipas Rregullës 154 si dhe kuadrin e kufizuar të fakteve dhe provave të kësaj çështjeje, Trupi Gjykses është i mendimit se koha e përlllogaritur prej 12 orësh nga ZPS-ja, është e tepërt. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i cakton ZPS-së 9 orë kohë në dispozicion në këtë çështje.²² Nëse ZPS-së do t'i nevojitet më shumë kohë për paraqitjen e përgjithshme të provave dhe argumenteve të saj, ajo duhet të kërkojë leje paraprakisht në kohë të mjaftueshme nga Trupi Gjykses. Trupi Gjykses pret që ZPS-ja të respektojë afatin

¹⁸ Shih KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 7 tetor 2024, publik, f. 325, rreshtat 9-15.

¹⁹ Mocioni sipas Rregullës 154, para. 1-2, 29.

²⁰ Shtojca 1 e Parashtrimeve të ZPS-së, f. 2.

²¹ KSC-BC-2023-10, F00177/A02, Prokurorja e Specializuar, Shtojca 2 e Parashtrimit prej Prokurorisë të Dosjes Paraprake, Listave të Dëshmitarëve dhe Provave Materiale, dhe Tabelës sipas Rregullës 109(c), 16 shkurt 2024, konfidenciale, f. 2.

²² Por, shih para. 29, 43-45 më poshtë.

kohor të përcaktuar prej Trupit Gjykues për marrjen në pyetje të dëshmitarëve prej saj, dhe të informojë sa më shpejt të jetë e mundur Trupin Gjykues nëse i nevojitet më pak kohë sesa ajo e caktuar nga Trupi Gjykues.

22. Gjithashtu, Trupi Gjykues udhëzon NJAGJ-në të informojë, përmes postës elektronike, Trupin Gjykues dhe palët:

(i) në fund të marrjes në pyetje të çdo dëshmitari nga ZPS-ja, se sa kohë ka përdorur faktikisht ZPS-ja; dhe

(ii) në fund të çdo blloku dëshmish, sa kohë ka përdorur gjithsej ZPS-ja për marrjen në pyetje të të gjithë dëshmitarëve të thirrur për të dëshmuar deri në atë moment.

2. Caktimi i kohës për Mbrojtjen

23. Duke pasur parasysh se në këtë çështje gjyqësore janë tre të akuzuar, çka mund të bëjë që pyetjet të përkojnë me njëra-tjetrën, Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme që, për marrjen në pyetje si palë jothirrëse të secilit dëshmitar të ZPS-së, t'i caktojë secilit ekip të Mbrojtjes 75 për qind të kohës të përdorur faktikisht nga ZPS-ja për marrjen në pyetje të dëshmitarit përkatës.²³ Nëse Mbrojtjes i nevojitet më shumë kohë për marrjen në pyetje të një dëshmitari, ajo duhet t'i kërkojë leje Trupit Gjykues sa më shpejt që të jetë e mundshme.

D. BLOQET E DËSHMIVE DHE RENDI I PARAQITJES SË DËSHMITARËVE

24. Trupi Gjykues cakton datat 9 deri 12 dhjetor 2024 dhe 16 deri 20 dhjetor 2024, për mbajtjen e seancave gjyqësore të bllokut të parë të dëshmive, në varësi të ndonjë vendimi të mëtejshëm të Trupit Gjykues. Trupi Gjykues gjithashtu vendos të

²³ Por, *shih* para. 29, 43, 45 më poshtë.

organizojë sesione shtesë (të katërt) (16:30-18:00), për seancat e javës nga 9 deri 12 dhjetor 2024.²⁴

25. Blloqet e tjera të dëshmimeve do të komunikohen në kohën e duhur përmes NJAGJ-së. Ndonëse blloqet e dëshmimeve do të caktohen në konsultim me palët dhe Zyrën Administrative, Trupi Gjykses pret që palët të jenë gati për të vazhduar me paraqitjen e provave të tyre, në qoftë se dëshmitarët janë në dispozicion për të dëshmuar.

26. Pasi ka marrë parasysh rendin e konfirmuar prej ZPS-së të paraqitjes së dëshmitarëve të saj,²⁵ Trupi Gjykses udhëzon ZPS-në që, në qoftë se ky rend ndryshon për shkak të rrethanave të paparashikuara, të informojë menjëherë Trupin Gjykses, Zyrën Administrative dhe Mbrojtjen.

27. Gjithashtu, Trupi Gjykses urdhëron ekipet e Mbrojtjes që deri në orën **16:00 të së premtes, 20 dhjetor 2024**, të dorëzojnë rendin e përgjithshëm të dëshmimeve që do të japin dëshmitarët përkatës të tyre. Trupi Gjykses gjithashtu urdhëron ekipet e Mbrojtjes që të dorëzojnë rendin e përditësuar të paraqitjes së dëshmitarëve përkatës të tyre për secilin llok dëshmish të paktën 30 ditë para fillimit të secilit bllok.²⁶ Në qoftë se rendi i paraqitjes së dëshmitarëve ndryshon pas këtij afati për shkak të rrethanave të paparashikuara, ekipi përkatës i Mbrojtjes duhet të informojë menjëherë ZPS-në, ekipet e tjera të Mbrojtjes, Zyrën Administrative dhe Trupin Gjykses.

²⁴ Në lidhje me këtë, *shih* poshtëshënimin 27 më poshtë.

²⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

²⁶ Afati i përcaktuar në këtë vendim nuk përjashton detyrimin e palës thirrëse për t'i dhënë Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) Formularin e Informacionit mbi Dëshmitarin të plotësuar për secilin dëshmitar sa më shpejt që të jetë e realizueshme dhe, në çdo rast, jo më vonë se 35 ditë pune para ditës që dëshmitari duhet të dëshmojë; KSC-BD-42/Rev3, Udhëzim i Zyrës Administrative, [WPSO Guidelines on Services to Witnesses Appearing Before the Specialist Chambers](#) (Udhëzime të ZMMD-së lidhur me Shërbimet për Dëshmitarët që Paraqiten para Dhomave të Specializuara), 27 shtator 2024, Pjesa 4(1).

E. PËRDORIMI EFIKAS I KOHËS NË SALLËN E GJYQIT

28. Palët e organizojnë paraqitjen e provave të tyre në një mënyrë që maksimizon përdorimin e kohës në dispozicion të tyre në sallën e gjyqit.²⁷ Për atë që është e mundur dhe e parashikueshme, ditët e seancave në sallën e gjyqit nuk duhet të lihen të papërdorura.

29. Marrja në pyetje duhet të kryhet gjithmonë në mënyrë sa më efektive. Palët duhet t'i përqendrojnë pyetjet e tyre marrjen e dëshmive që lidhen me vërtetimin e elementëve përbërës të veprave penale dhe të formave të përgjegjësisë penale për të cilat janë ngritur akuzat, ose në fakte të tjera thelbësore për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarve, në aspektet që kanë lidhje me besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave, dhe përcaktimin e dënimit në rast të shpalljes fajtor. Në qoftë se marrja në pyetje do të gjykohej e paefektshme, ajo do të kufizohet, edhe nëse nuk e kalon kohën e përlogaritur dhe/ose të caktuar.²⁸ Trupi Gjykes nuk do të tolerojë dhënien e dëshmive për fakte që nuk kanë lidhje me akuzat. Palët kanë gjithashtu përgjegjësinë të sigurojnë që dëshmitarët të ruajnë përqendrimin në dhënien e përgjigjeve të tyre.

30. Gjithashtu, palët duhet të jenë gjithmonë të përgatitura që të vazhdohet me paraqitjen e provave, edhe nëse për një dëshmitar të caktuar nevojitet më pak kohë se sa ishte përlogaritur. Nëse është vendosur që disa dëshmitarë të japin dëshmi në një javë të caktuar ose gjatë një blloku dëshmish, Trupi Gjykes pret që të fillohet menjëherë me marrjen në pyetje të dëshmitarit të radhës, pasi të ketë përfunduar marrja në pyetje e dëshmitarit pararendës.

²⁷ Seanca ditore e zakonshme në gjykatë ndahet në tre sesione nga një orë e gjysmë secili, me pushime mes sesioneve (09:30-11:00; 11:30-13:00; 14:30-16:00). Kur është e nevojshme, Trupi Gjykes mund të organizojë një sesion i katërt (16:30-18:00).

²⁸ Rregulla 143(4) e Rregullores.

31. Në planifikimin e paraqitjes së dëshmitarëve të tyre, palët marrin parasysh kohën që u është caktuar palëve të tjera për pyetjet e tyre, si edhe pyetjet që mund të bëhen nga Trupi Gjykses.

32. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh parashtrimet e ZPS-së,²⁹ dhe për të siguruar që procesi të kryhet në mënyrë efikase dhe të shpejtë, Trupi Gjykses u kërkon palëve që të shmangin ngritjen e aspekteve që mund të vonojnë në mënyrë të panevojshme ecurinë e procesit, përveç rasteve kur aspekti ose aspektet në fjalë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në dëshminë që pritët të japë një dëshmitar, ose kur kjo bëhet për qëllime të tjera legjitime. Në veçanti, përpara se t'i drejtohen Trupit Gjykses, palët angazhohen në konsultime *inter partes* me synimin për të zgjidhur ndërmjet tyre çdo aspekt që buron nga procesi. Gjithashtu, përpara se të ngrenë një aspekt ose aspekte në gjykatë, palët njoftojnë me shkrim ose gojarisht Trupin Gjykses dhe palët e tjera për synimin e tyre për ta bërë këtë. Ky njoftim përmban një përshkrim të shkurtër për sa vijon: (i) aspektin konkret; (ii) ecurinë e diskutimeve të palëve; dhe (iii) mjetin juridik të kërkuar, bazën ligjore për të, si dhe të gjitha dokumentet relevante me numrat përkatës të regjistrimit si provë (ERN) që do të përdoren gjatë ngritjes së atij aspekti.

F. MARRJA NË PYETJE ME VIDEOKONFERENCË DHE MARRJA NË PYETJE E
DËSHMITARËVE JASHTË VENDIT KU MBAHET GJYKIMI

33. Trupi Gjykses vlerëson se dhënia e dëshmisë në sallë dhe dhënia e dëshmisë me videokonferencë, sipas rregullës 144 të Rregullores, janë mundësi të barabarta për dhënien e dëshmisë gojore sipas kuadrit ligjor të DHS-së.

34. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk synon të kërkojë që dëshmitarët e saj të japin dëshmi me videokonferencë. Ekipet e Mbrojtjes udhëzohen të dorëzojnë çdo kërkesë

²⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 40-41.

për dhënie dëshmie sipas rregullës 144 të Rregullores në momentin e dorëzimit të rendit të përgjithshëm të dëshmimeve të dëshmitarëve përkatës të tyre dhe më së voni deri **të premten, 20 dhjetor 2024, në orën 16:00**, për të mundësuar marrjen e masave të nevojshme praktike. Në momentin e dorëzimit të rendit të përditësuar të paraqitjes së dëshmitarëve, sipas paragrafit 27 më lart, Mbrojtja bën të ditur nëse parashihet që dëshmitari të dëshmojë me videokonferencë.

35. Palëve u lejohet një shkallë e caktuar fleksibiliteti në marrjen e vendimit nëse dëshirojnë që dëshmitarët të paraqiten personalisht apo me videokonferencë, dhe për t'i paraqitur kërkesën e duhur Trupit Gjykses në lidhje me këtë. Megjithatë, kjo do të peshohet kundrejt faktorëve të tjerë, si ngarkesat logjistike të Zyrës Administrative dhe detyrimin e Trupit Gjykses sipas nenit 40(2) të Ligjit, për të siguruar që gjykimi të jetë i drejtë, i shpejtë dhe të kryhet duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve. Gjithashtu, siç përcaktohet në rregullën 144(2) të Rregullores, është shumë e rëndësishme që vendi i zgjedhur për dhënien e dëshmisë me videokonferencë të jetë i përshtatshëm për dhënien e saj me vërtetësi dhe në mënyrë të hapur dhe të garantojë sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rezervon të drejtën të rivlerësojë formën e dhënies së dëshmisë të zgjedhur nga pala thirrëse dhe të vendosë ndryshe sa herë që e konsideron të nevojshme.

36. Sa i takon marrjes në pyetje të dëshmitarëve jashtë vendit ku mbahet gjykimi, në bazë të rregullës 145 të Rregullores, palët udhëzohen të dorëzojnë në rastin më të parë çdo kërkesë për dhënie të dëshmisë sipas rregullës së lartpërmendur, me t'u bërë e qartë pamundësia e dëshmitarit për t'u paraqitur, në mënyrë që të mundësohet marrja e masave të nevojshme praktike.

G. MASAT MBROJTËSE NË GJYKATË DHE MASAT E POSAÇME

37. Trupi Gjykues rikujton se për të dy dëshmitarët e ZPS-së janë miratuar masa mbrojtëse në gjykatë.³⁰

38. Gjithashtu, Trupi Gjykues rikujton se ka urdhëruar ekipet e Mbrojtjes që çdo kërkesë për masa mbrojtëse në gjykatë për dëshmitarët që synojnë të thërrasin, ta paraqesin jo më vonë se në momentin e dorëzimit të listës (përfundimtare) të dëshmitarëve të tyre.³¹ Çdo kërkesë tjetër shtesë e ekipeve të Mbrojtjes për masa mbrojtëse në gjykatë duhet të bëhet në momentin e dorëzimit të rendit të përgjithshëm të dëshmimeve të dëshmitarëve përkatës të tyre dhe jo më vonë se **të premten, 20 dhjetor 2024, në orën 16:00.**

39. Sa u përket masave të posaçme sipas rregullës 80(4)(c) të Rregullores, Trupi Gjykues përcakton nevojën për masa të tilla pas marrjes së vlerësimit të cenueshmërisë të përgatitur nga ZMMD-ja.³²

H. RENDI DHE FORMA E MARRJES NË PYETJE TË DËSHMITARËVE

40. Në bazë të rregullës 127(3) të Rregullores, dëshmitarët merren në pyetje sipas kësaj renditjeje:

³⁰ KSC-BC-2023-10, F00087, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Njoftimin e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën në lidhje me To*, 2 nëntor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më të njëjtën ditë, F00087/CONF/RED; F00131, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse për Materiale të Rregullës 102(1)(b)*, 13 dhjetor 2023, konfidencial; KSC-BC-2023-11, F00029, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën në lidhje me To*, 11 janar 2024, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më të njëjtën ditë, F00029/CONF/RED.

³¹ *Shih* KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 8 tetor 2024, konfidencial, nga f. 370, rreshti 23 deri në f. 372, rreshti 17.

³² Trupi Gjykues do të lëshojë udhëzime të mëtejshme në vendimin e tij mbi informimin në tërësi të dëshmitarëve.

(i) Dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja në fillim do të pyeten prej ZPS-së dhe më pas prej Mbrojtjes në cilësinë e palës jothirrëse;

(ii) Dëshmitarët e thirrur nga Mbrojtja do të pyeten fillimisht nga ekipi i Mbrojtjes që është pala thirrëse, pastaj ekipet e tjera të Mbrojtjes dhe më pas nga ZPS-ja në cilësinë e palës jothirrëse; dhe

(iii) dëshmitarët e thirrur nga Trupi Gjykses *proprio motu*, do të pyeten në fillim nga Trupi Gjykses, pastaj ZPS-ja dhe në fund Mbrojtja.

41. Trupi Gjykses udhëzon ekipet e Mbrojtjes që të koordinohen ndërmjet tyre për radhën në të cilën do të marrin në pyetje secilin dëshmitar në cilësinë e palës (jo)thirrëse. Mbrojtja do të informojë Trupin Gjykses nëse është arritur një pajtim i tillë jo më vonë se një (1) javë para paraqitjes së dëshmitarit.

42. Sipas rregullës 127(3) të Rregullores, Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje plotësuese të palës thirrëse, në qoftë se konsiderohet e nevojshme. Po kështu, Trupi Gjykses mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit në çdo fazë. Më tej, para marrjes në pyetje të dëshmitarëve, Kryegjykatësja mund t'u japë atyre mundësinë të japin versionin e tyre të ngjarjeve për të cilat janë thirrur të dëshmojnë. Kjo mundësi mund t'u jepet dëshmitarëve edhe gjatë ose pas marrjes në pyetje nga një palë, sipas diskrecionit të Kryegjykatësës.

43. Marrja në pyetje e dëshmitarëve duhet të kryhet në pajtim me rregullën 143 të Rregullores. Domosdoshmëria ose korrektësia e çdo pyetjeje do të trajtohet rast pas rasti, duke mbajtur parasysh kompetencat e Trupit Gjykses dhe të Kryegjykatësës, sipas nenit 40(2) dhe (6) të Ligjit dhe rregullës 143(4) të Rregullores.

44. Kur zbaton rregullën 154 të Rregullores, Trupi Gjykses pret që pala thirrëse t'i thjeshtojë në mënyrë të konsiderueshme pyetjet, duke pasur parasysh se kjo dispozitë mundëson dorëzimin zyrtarisht të deklaratës apo deklaratave me shkrim dhe/ose të transkriptit apo transkripteve të dëshmitarëve në vend të marrjes në pyetje në gjykim.

45. Gjithashtu, e gjithë marrja në pyetje duhet të bëhet në mënyrë të përqendruar, të saktë dhe të përmbledhur. Palët inkurajohen fuqimisht të shmangin pyetjet e gjata dhe të ndërlikuara. Siç u theksua edhe më lart, marrja në pyetje duhet të kryhet gjithmonë në mënyrën më efikase të mundshme. Në përputhje me kompetencat e Kryegjykatësës në bazë të rregullës 143(4) të Rregullores, në rastet kur marrja në pyetje gjykohet joefikase, ajo do të kufizohet.³³ Në parim, palët duhet t'i marrin në pyetje dëshmitarët në mënyrë asnjane. Pyetjet sugjeruese dhe ato me përgjigje të parapërcaktuara mund të lejohen, nën kontrollin e Kryegjykatësës, vetëm kur ndihmojnë përshejtimin e procesit dhe përcaktimin e së vërtetës, sipas rregullës 143(4) të Rregullores.

46. Çdo kundërshtim ndaj një pyetjeje duhet të bëhet vetëm për qëllimet e parashikuara në rregullën 143(4) të Rregullores. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh kompetencat *proprio motu* të Kryegjykatësës në bazë të rregullës së lartpërmendur, palët ngrenë kundërshtime vetëm kur është absolutisht e domosdoshme. Kundërshtimet duhet t'i paraqiten Trupit Gjykses në momentin kur bëhet pyetja, të jenë të shkurtra e konkrete, dhe të shpjegojnë si lidhet kundërshtimi me qëllimet e përcaktuara në rregullën 143(4) të Rregullores. Pala që paraqet kundërshtimin ka përgjegjësinë që:

(i) të kërkojë, nëse është e nevojshme, kalimin në seancë private ose të mbyllur përpara paraqitjes së kundërshtimit, dhe të informojë Trupin Gjykses për arsyet pse po e kërkon këtë; dhe

(ii) të bëjë të ditur, përpara se të paraqesë argumente materiale në lidhje me kundërshtimin, nëse është e përshtatshme të diskutohen arsyet e kundërshtimit në praninë e dëshmitarit, për t'i dhënë kështu mundësi Kryegjykatësës të vendosë nëse është më mirë që çështja të trajtohet në mungesë të dëshmitarit. Kryegjykatësja vendos rast pas rasti për çdo kundërshtim.

³³ *Shih* para. 29 më lart.

47. Zyra Administrative informon Trupin Gjykses përmes postës elektronike një (1) ditë përpara datës së caktuar për dhënien e dëshmisë të secilit dëshmitar, nëse dëshmitari flet dhe/ose kupton anglisht.

I. PËRDORIMI I MATERIALEVE GJATË MARRJES NË PYETJE TË DËSHMITARËVE

48. Të paktën tetë (8) ditë pune para se dëshmitari të fillojë dhënien e dëshmisë, nëse nuk janë dhënë udhëzime të tjera, pala thirrëse:

(i) kalon në sistemin *Legal Workflow* radhën e paraqitjes së materialeve që do të përdorë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit; dhe

(ii) përmes postës elektronike i jep Trupit Gjykses, NJAGJ-së dhe palëve jothirrëse listën e materialeve përkatëse.³⁴

49. Në listë duhet të shënohet:

(i) pjesët që synohet të përdoren nga çdo dokument që është më i gjatë se dy (2) faqe;³⁵

(ii) numri ERN me të cilin mund të gjendet materiali në sistemin *Legal Workflow*;

(iii) data e nxjerrjes së materialit dhe paketa ose paketat gjegjëse të materialeve të nxjerra;

(iv) nëse pala thirrëse synon ta paraqesë materialin si provë; dhe

(v) nëse materiali mund të transmetohet për publikun. Prova identifikuese, si fotografitë e të akuzuarve ose të vendit ku pretendohet se u kryen krimet, në parim, nuk transmetohen për publikun.

³⁴ Pala thirrëse e paraqet këtë material më së voni deri në orën 16:00 të ditës kur përfundon afati.

³⁵ Trupi Gjykses sqaron se, në lidhje me deklaratën ose deklaratat me shkrim dhe/ose transkriptin ose transkriptet e dëshmimeve (të mëhershme) të një dëshmitari, nuk është e nevojshme që palët, kur dorëzojnë listat e tyre, të bëjnë të ditur se cilat pjesë saktësisht do të përdoren me dëshmitarin.

50. Lista e lartpërmendur shërben vetëm për njoftim dhe nuk përbën parashtrim zyrtar dokumentesh. Çdo kundërshtim ndaj përdorimit të këtyre materialeve duhet t'i njoftohet me postë elektronike Trupit Gjykses dhe të gjitha palëve të tjera brenda tri (3) ditësh pune.³⁶ Përgjigjet ndaj kundërshtimeve, nëse do të ketë, i dorëzohen me postë elektronike Trupit Gjykses dhe të gjitha palëve të tjera brenda dy (2) ditësh pune nga marrja e njoftimit për kundërshtimin ose kundërshtimet.³⁷ Nuk do të pranohen kundërpërgjigje. Trupi Gjykses do të marrë vendim për çdo kundërshtim përpara se materiali të përdoret.

51. Të paktën tri (3) ditë pune para se dëshmitari të fillojë të japë dëshmi, palët jothirrëse duhet:

- (i) përmes postës elektronike, t'i japin Trupit Gjykses dhe të gjitha palëve të tjera listën e materialeve që do të përdorin gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit prej tyre, që përmban informacionin e përcaktuar në paragrafin 49 më lart; dhe
- (ii) të pasqyrojnë në *Legal Workflow* radhën e paraqitjes së materialeve përkatëse, në qoftë se ato nuk ishin të përfshira në radhën e paraqitjes së materialeve të palës thirrëse apo të ndonjë pale tjetër.³⁸

52. Çdo kundërshtim ndaj përdorimit të këtyre materialeve duhet t'i njoftohet me postë elektronike Trupit Gjykses dhe të gjitha palëve të tjera brenda dy (2) ditësh pune nga komunikimi i listës.³⁹ Përgjigjet ndaj kundërshtimeve, nëse do të ketë, i dërgohen me postë elektronike Trupit Gjykses dhe të gjitha palëve të tjera para se pala thirrëse të përfundojë marrjen në pyetje të dëshmitarit. Kundërpërgjigjet nuk do të pranohen. Trupi Gjykses do të marrë vendim për kundërshtimin përpara se materiali të përdoret.

³⁶ Çdo kundërshtim i komunikohet Trupit Gjykses deri në orën 16:00 të ditës kur përfundon afati.

³⁷ Çdo përgjigje i komunikohet Trupit Gjykses deri në orën 16:00 të ditës kur përfundon afati.

³⁸ Palët jothirrëse e dorëzojnë këtë material deri në orën 16:00 të ditës kur përfundon afati.

³⁹ Çdo kundërshtim i komunikohet Trupit Gjykses deri në orën 16:00 të ditës kur përfundon afati.

53. Si rregull i përgjithshëm, gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari, palët mund të përdorin vetëm materiale që janë nxjerrë dhe njoftuar në *Legal Workflow*. Në qoftë se materiali nuk është nxjerrë më parë, palët:

(i) e nxjerrin pa vonesë materialin në *Legal Workflow* jo më vonë se kur dorëzojnë listën ose listat e materialeve që do të përdorin, sikurse udhëzohet në paragrafët 48 dhe 51;

(ii) e përfshijnë materialin në fjalë në listën apo listat e materialeve që do të përdorin dhe në radhën e paraqitjes së provave, në përputhje me paragrafët 48 dhe 51; dhe

(iii) kërkojnë leje nga Trupi Gjykses për të përdorur materialin dhe bëjnë të ditur arsyen pse materiali nuk është nxjerrë më parë. Kërkesa për leje bëhet me postë elektronike dhe i drejtohet Trupit Gjykses, dhe i dërgohet gjithashtu NJAGJ-së dhe të gjitha palëve tjera, kur jepet lista apo listat e materialeve që do të përdoren. Çdo kundërshtim bëhet duke respektuar afatet e përcaktuara në paragrafët 50 dhe 52. Trupi Gjykses do të marrë vendim mbi kërkesën përpara përdorimit të synuar të materialit.

54. Kur t'i referohet materialit gjatë dhënies së dëshmisë nga dëshmitari, përfshirë deklaratën apo deklaratat me shkrim dhe/ose transkriptin apo transkriptet e dëshmimeve (të mëhershme) të dhëna nga dëshmitari, pala që bën pyetjet duhet:

(i) të evidentojë qartë materialin me numrin përkatës ERN (ose numrat ERN, sipas rastit) dhe të bëjë të ditur faqen dhe/ose numrin e paragrafit apo paragrafëve përkatës;

(ii) kur bëhet fjalë për transkripte, pala që bën pyetjet duhet të evidentojë edhe rreshtin apo rreshtat konkretë që citohen ose të cilëve u referohet; dhe

(iii) të nxjerrë materialin në ekran dhe të bëjë të ditur nëse ai mund të transmetohet për publikun. Kur ekzistojnë versionet në anglishte dhe shqipe, nxirren në ekran të dyja versionet.

55. Kur materiali audioviziv i përdorur gjatë seancave përmban gjuhë të folur, pala që synon ta përdorë atë material duhet të japë numrin ERN të transkriptit përkatës në anglishte.⁴⁰ Përkthyesit me gojë të gjykatës duhet të informohen mjaftueshëm se cila pjesë e transkriptit përkon me cilën pjesë të materialit audioviziv që po shfaqet. Në këto raste, përkthyesit lexojnë me zë vetëm atë pjesë të transkriptit që u është dhënë në gjuhën angleze, për qëllimin e përfshirjes së tij në dokumentacionin e çështjes, dhe nuk u kërkohet të përkthejnë drejtpërdrejt materialin audioviziv. Nëse palët nuk pajtohen me saktësinë e transkriptit të lexuar në sallën e gjyqit, mund të kërkojnë bërjen e korrigjimeve në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimin e Zyrës Administrative për Parashtrimin e Kërkesave për Përkthim me Shkrim dhe me Gojë dhe Kërkesave për Verifikim.⁴¹

56. Së fundi, palët sigurojnë që materiali që duan të përdorin gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari, të mos përmbajë të dhëna identifikuese të dëshmitarëve të tjerë për të cilët janë miratuar masa mbrojtëse. Trupi Gjykses udhëzon palët që, në rast se dëshirojnë të përdorin një material që përmban informacion të tillë, të bëjnë në të redaktimet e duhura, për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve dhe informacionin konfidencial përkatës

⁴⁰ KSC-BC-2023-10, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Gjuhën e Punës*, 12 tetor 2023, publik, para. 14, 16; KSC-BC-2023-11, F00019, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Gjuhën e Punës*, 14 dhjetor 2023, publik, para. 14, 16.

⁴¹ KSC-BD-14/COR, Administratorja, [Registry Instruction on Requesting Translation, Interpretation and Verification Services](#) (Udhëzim i Zyrës Administrative për Parashtrimin e Kërkesave për Përkthim me Shkrim dhe me Gojë dhe Kërkesave për Verifikim), 30 maj 2019, publik.

J. PROCESI PUBLIK DHE PËRDORIMI I SEANCave PRIVATE DHE/OSE TË

MBYLLURA

57. Fillimisht, Trupi Gjykues thekson se gjatë gjithë kohës palët duhet të respektojnë dhe të tregojnë tërë kujdesin e nevojshëm për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit, veçanërisht identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur ose informacionin konfidencial që mund të zbulojë identitetin dhe vendndodhjen e tyre, në përputhje me Ligjin, Rregulloren, urdhrat dhe vendimet e Trupit Gjykues dhe të Kryegjykatëses, Kodin e Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër në fuqi.⁴²

58. Gjatë seancave të hapura dhe në parashtrimet publike me shkrim, palët mund t'u referohen aspekteve konfidenciale vetëm në një mënyrë që nuk zbulon informacionin e mbrojtur nga klasifikimi si konfidencial.

59. Për aq sa është e mundshme, dëshmitarët japin dëshmi në seancë publike.⁴³ Gjithashtu palët udhëzohen që, aq sa është e mundur, t'i grupojnë pyetjet identifikuese së bashku, për të shmangur kalimin në mënyrë të përsëritur në seancë private dhe/ose të mbyllur. Kërkesat për seancë private dhe/ose të mbyllur dhe arsyetimi i tyre duhen bërë, nëse është e mundshme, në mënyrë neutrale dhe objektive, duke përmendur temat që do të trajtohen. Arsyet për to duhet të jepen ose në seancë publike, nëse është e mundshme, ose ndryshe në fillim të seancës private ose të mbyllur të kërkuar. Është përgjegjësi e palës që bën pyetjet të kërkojë kthimin në seancë publike kur arsyet që bënë të nevojshëm kalimin në seancë private ose të mbyllur nuk janë më të pranishme. Sa më lart nuk nënkupton që Trupi Gjykues nuk

⁴² *Shih, ndër të tjera*, nenin 12 të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

⁴³ Neni 21(2) i Ligjit.

mund të bëjë vlerësim gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarit lidhur me nevojën për seancë private ose të mbyllur.

K. REDAKTIMET GJATË SEANCEVE

60. Kërkesat e bëra nga palët gjatë një seance për redaktimin e diçkaje të thënë në mënyrë të paqëllimshme në seancë publike, duhet të bëhen përmes postës elektronike, për të mos tërhequr vëmendjen në mënyrë të papërshtatshme ndaj informacionit konfidencial. Mesazhi elektronik dërgohet në adresën e postës elektronike të Trupit Gjykses, si dhe sekretarit të gjykatës dhe përfaqësuesve të palëve të tjera të pranishëm në sallën e gjyqit.⁴⁴ Në kërkesë duhet të evidentohet qartë fjala ose fjalët që duhet të redaktohen dhe orën ose orët, faqen ose faqet dhe numrin ose numrat e rreshtave të transkriptit në kohë reale. Këto kërkesa duhet të bëhen sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) minuta pas zbulimit të informacionit. Palëve të pranishme në sallën e gjyqit duhet t'u jepen pesë (5) minuta kohë për të paraqitur kundërshtime, nëse dëshirojnë. Më pas, Kryegjykatësja merr vendim në lidhje me kërkesën.

61. Para hapjes së çështjes gjyqësore, NJAGJ-ja u komunikon palëve adresën e postës elektronike të Trupit Gjykses.

62. Nëse e gjykojnë të nevojshme, palët gjithashtu mund t'i kërkojnë Trupit Gjykses kalimin në seancë private dhe të bëjnë kërkesë gojore për lëshimin e një urdhri për redaktim, ku të evidentojnë fjalën ose fjalët që duhet të redaktohen dhe orën ose orët, faqen ose faqet dhe numrin ose numrat e rreshtave të transkriptit në kohë reale.

63. Pajtimi i palëve për redaktimet, nuk ka fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses dhe procedura e lartpërmendur nuk cenon kompetencën *proprio motu* të Trupit Gjykses

⁴⁴ Palët konsultohen *inter partes* dhe informojnë njëra-tjetrën për se cili anëtar ose cilët anëtarë të ekipeve të tyre përkatëse duhet t'i marrin këto komunikime elektronike.

për të vendosur në lidhje me nevojën për redaktime. Gjithashtu, për shkak të pamundësisë për të bërë një vlerësim të hollësishëm gjatë ose menjëherë pas seancës, redaktimet e kryera gjatë seancave nuk nënkuptojnë që ky vlerësim nuk mund të rishikohet më vonë nga Kryegjykatësja.

L. VETINKRIMINIMI I DËSHMITARIT

64. Palët, kur është e parashikueshme, duhet të japin njoftim mbi kërkesa të mundshme për garanci sipas rregullës 151(3) të Rregullores. Duke pasur parasysh se paraqitja e provave do të fillojë **të hënën, më 9 dhjetor 2024**, Trupi Gjykses vendos **të hënën, 25 nëntor 2024**, si afat për këto kërkesa për dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja. Mbrojtja duhet ta japë këtë njoftim të paktën 14 ditë para se dëshmitari të japë dëshmi.

65. Zyra Administrative duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'u ofruar këshilla të pavarura juridike dëshmitarëve që mund të rrezikojnë të vetinkriminohen gjatë dhënies së dëshmisë.⁴⁵ Kjo nuk paragjykon vlerësimin e Trupit Gjykses nëse do të jepen apo jo garanci sipas rregullës 151(3) të Rregullores.

66. Mbrojtësi që i jep këshilla dëshmitarit që mund të jetë në rrezik vetinkriminimi, i drejtohet paraprakisht në kohë të mjaftueshme Trupit Gjykses me kërkesë për garanci sipas rregullës 151(3) të Rregullores, nëse është e nevojshme. Palët informohen për kërkesën dhe ZPS-ja paraqet pikëpamjet e veta *ex parte* sipas rregullës 151(3) të Rregullores, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më pak se dy (2) ditë pune para dëshmisë së dëshmitarit në fjalë *ex parte* sipas rregullës 151(3) të Rregullores, për t'i dhënë mundësi Trupit Gjykses të vendosë për këto aspekte përpara fillimit të dëshmisë së dëshmitarit. Mbrojtësi që këshillon dëshmitarin është përgjegjës për ta informuar atë, ndër të tjera, për dispozitat e nenit 15(2) të Ligjit dhe të rregullës 65 të Rregullores.

⁴⁵ Shih gjithashtu rregullën 151(4) dhe (6) të Rregullores.

M. DËSHMITARËT EKSPERTË

67. Trupi Gjykues rikujton se aktekspertizat e dëshmitarëve ekspertë ose pjesë të tyre mund të pranohen si prova pa i thirrur ekspertët për të dëshmuar në gjykim, në qoftë se pala kundërshtare i pranon ato, ose pjesët e tyre, siç përcaktohet në rregullën 149(3) të Rregullores. Por, në qoftë se pala kundërshtare nuk i pranon aktekspertizat ose pjesë të tyre apo dëshiron t'u bëjë pyetje dëshmitarëve ekspertë ekspertët thirren për të dëshmuar në gjykim, sipas rregullës 149(2) dhe (4) të Rregullores.

68. Për të siguruar kryerjen me efikasitet të procesit, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve ekspertë ZPS-ja duhet t'i thjeshtojë pyetjet e saj dhe të shmangë ato që synojnë marrjen e informacionit që gjendet në aktekspertizat e tyre e që do të ishte përsëritje e tij. Pala thirrëse duhet t'i përqendrojë pyetjet në sqarimin dhe plotësimin e aktekspertizave të dëshmitarëve ekspertë, sipas nevojës. Pas marrjes në pyetje të çdo dëshmitari ekspert, pala thirrëse kërkon gojarisht, gjatë seancës, pranimin si provë të aktekspertizave dhe materialeve shoqëruese.

69. Sipas rregullës 149(4) të Rregullores, Trupi Gjykues vendos mbi pranueshmërinë e aktekspertizave pas dhënies së dëshmive nga ekspertët dhe marrjes në pyetje të tyre.

70. Procedura e përcaktuar më sipër në Pjesën III.H në lidhje me rendin dhe formën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, zbatohet *mutatis mutandis* edhe për marrjen në pyetje të dëshmitarëve ekspertë, përveçse kur urdhërohet ndryshe.

N. RREGULLAT 153-155 TË RREGULLORES

71. Trupi Gjykses rikujton se rregullat 153 dhe 154 janë dispozita të dobishme për të përshpejtuar dhe thjeshtësuar procesin.⁴⁶

72. Trupi Gjykses rikujton se ka urdhëruar ekipet e Mbrojtjes që, kur të dorëzojnë listën (përfundimtare) të dëshmitarëve të tyre, të bëjnë të ditur nëse synojnë të paraqesin kërkesa sipas rregullave 153-155 të Rregullores.⁴⁷ Afatet përkatëse për dorëzimin e këtyre kërkesave do të caktohen nga Trupi Gjykses në një fazë të mëvonshme të procesit.

O. FAKTE TË PRANUARA NGA PALËT

73. Trupi Gjykses mban parasysh pikat për të cilat ZPS-ja dhe, përkatësisht, Mbrojtja e Bahtjarit dhe Mbrojtja e Shalës, pajtohen.⁴⁸

P. FAKTET E NJOHURA NGA GJITHKUSH

74. Trupi Gjykses udhëzon ZPS-në që, nëse dëshiron, të dorëzojë kërkesë sipas rregullës 157(1) të Rregullores deri **të mërkurën, 20 nëntor 2024**.

Q. PARASHTRIMET LIDHUR ME PROCEDURËN E PËRCAKTIMIT TË DËNIMIT

75. Në përputhje me rregullën 159(6) të Rregullores, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në dhe Mbrojtjen që, jo më vonë se **të hënën, 25 nëntor 2024**, të dorëzojnë parashtime lidhur me nëse, në rast të shpalljes fajtor të ndonjë prej të akuzuarve për një apo më shumë vepra penale për të cilat akuzohet, Trupi Gjykses të përcaktojë dënimet

⁴⁶ Vendimi mbi Konferencat Përgatitore për Gjykimin, para. 17. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00169, Trupi Gjykses I, [*Decision on the submission and the admissibility of evidence*](#) (Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave), 25 gusht 2021, publik, para. 29.

⁴⁷ *Shih* KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 8 tetor 2024, konfidencial, nga f. 370, rreshti 23 deri në f. 372, rreshti 17.

⁴⁸ KSC-BC-2023-10, F00296, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim për Faktet dhe Pikat Juridike për të Cilat ka Pajtim*, 17 maj 2024, publik, para. 5-6, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

përkatëse me shpalljen e Aktgjykimit, apo të procedojë në përputhje me rregullat 162 dhe 164 të Rregullores. Gjithashtu, palët duhet të bëjnë parashtrime nëse kanë prova shtesë që duan të paraqesin në lidhje me përcaktimin e dënimit, përfshirë nëse dëshirojnë të thërrasin dëshmitarë. Kjo nuk ndikon në vendimin e Trupit Gjykses në lidhje me shpalljen e të akuzuarve fajtorë ose të pafajshëm për një apo më shumë vepra penale të përfshira në Aktakuzë.

R. DORËZIMI I PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA

76. Trupi Gjykses u kujton palëve që t'u përmbahen afateve të përcaktuara nga Trupi Gjykses për çdo aspekt. Në rast se palët nuk mund t'u përmbahen afateve të përcaktuara, ato, pa përjashtim, duhet të dorëzojnë një kërkesë me arsye të vlefshme sipas rregullës 9(5) të Rregullores, ku të kërkojnë zgjatjen e afatit.

77. Trupi Gjykses gjithashtu u kujton palëve nenin 40 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e parashtrimeve, në të cilin thuhet si vijon:

Nëse nuk është udhëzuar ndryshe, parashtrimet gjatë fazës së gjykimit duhet të përmbajnë, sipas rastit, si vijon:

a. një hyrje që përmban: (i) bazën ligjore të parashtrimit, ku përmenden konkretisht dispozitat përkatëse të Ligjit, Rregullores dhe/ose jurisprudenca e zbatueshme; dhe (ii) sipas rastit, një përmbledhje të vendimit ose të masës ndreqëse të kërkuar dhe të arsyeve në mbështetje të kërkesës, ose nëse vendimi apo masa ndreqëse e kërkuar mbështetet apo kundërshtohet;

b. një përshkrim të shkurtër të historisë dhe fakteve procedurale përkatëse, duke përfshirë kronologjinë, sipas rastit;

c. të gjitha argumentet ligjore dhe faktike përkatëse, ku përmendet konkretisht ligji përkatës i cili shërben si bazë;

d. një përfundim me një përshkrim të shkurtër të vendimit ose të masës ndreqëse të kërkuar, ose nëse vendimi apo masa ndreqëse e kërkuar mbështetet apo kundërshtohet, sipas rastit; dhe

e. një shtojcë që përmban një listë të burimeve ligjore të përmendura në parashtrim dhe kopje të këtyre burimeve në përputhje me nenin 32, sipas rastit.⁴⁹

78. Trupi Gjykues u kërkon palëve t'u përmbahen këtyre kritereve për çdo kërkesë të ardhshme, dhe gjithashtu kritereve të formatimit të parashtrimeve, të përcaktuara në nenin 30 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara.⁵⁰

79. Trupi Gjykues do të ushtrojë diskrecionin e tij për të rrëzuar parashtrimet që nuk dorëzohen në përputhje me Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara dhe brenda afateve të përcaktuara .

80. Së fundi, sa u takon specifikisht parashtrimeve me më shumë se tri (3) shtojca, Trupi Gjykues udhëzon palët që, së pari, të përfshijnë, si Shtojcë 1, tabelën e përmbajtjes ku të renditen të gjitha shtojcat bashkëlidhur parashtrimit themelor, me një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së çdo shtojce, përfshirë kodet përkatëse të dëshmitarëve dhe/ose numrat ERN.

S. RIKLASIFIKIMI I PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA DHE TRANSKRIPTEVE

81. Duke pasur parasysh parimin e procesit publik, Trupi Gjykues jep udhëzimet e mëposhtme në lidhje me riklasifikimin e parashtrimeve të protokolluara dhe transkripteve.

82. Siç përcaktohet në rregullën 82(3) të Rregullores, kur dorëzohet një parashtrim i klasifikuar si konfidencial ose rreptësisht konfidencial, palët dhe Zyra Administrative, sipas rastit, paraqesin arsyet për klasifikimin e kërkuar. Pala që dorëzon parashtrimin

⁴⁹ KSC-BD-15, Administratorja, [Registry Practice Direction on Files and Filings before the Kosovo Specialist Chambers](#) (Udhëzues Pune i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës), 17 maj 2019, publik.

⁵⁰ *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2023-10, F00538, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Kërkesën e Bahtijarit për Nxjerrjen e Materialit për Ekspertin*, 17 tetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 8. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 29 tetor 2024, F00538/RED.

ose, sipas rastit, Zyra Administrative, duhet të bëjë të ditur edhe kur nuk ka kundërshtim që parashtrimi të riklasifikohet.

83. Palët dhe Zyra Administrative dorëzojnë versione të redaktuara publike dhe/ose konfidenciale, sipas rastit, mundësisht dhe aq sa është e realizueshme, në të njëjtën kohë me parashtrimin fillestar, ose ndryshe brenda tre (3) ditësh pas dorëzimit të parashtrimit fillestar. Kur nuk ekzistojnë më arsyet për mbajtjen e klasifikimit fillestar, pala që dorëzon parashtrimin ose, sipas rastit, Zyra Administrative, kërkon riklasifikimin e tij, në bazë të rregullës 82(5) të Rregullores.⁵¹

84. Gjithashtu, me qëllim të respektimit të parimit të procesit publik dhe ruajtjen në të njëjtën kohë të masave mbrojtëse për dëshmitarët, Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme të urdhërojë palët dhe Zyrën Administrative⁵² të kryejnë në vijimësi rishikimin e transkripteve të seancave gjyqësore, pas përfundimit të secilit bllok dëshmish. Palët dhe Zyra Administrative komunikojnë mes tyre dhe dorëzojnë parashtrime të përbashkëta, në një parashtrim përmbledhës, brenda dy (2) javësh nga përfundimi i çdo blloku dëshmish, për heqjen ose jo të redaktimeve ekzistuese dhe/ose riklasifikimin e transkripteve si publike.⁵³ Ato duhet të japin arsyet pse redaktimi/klasifikimi nuk është më i nevojshëm, të cilat duhet të jenë të detajuara dhe konkrete në masë të mjaftueshme, për të mundësuar marrjen e vendimit nga Trupi Gjykues. Çka është e rëndësishme, Trupi Gjykues udhëzon palët dhe Zyrën Administrative që, kur bëjnë parashtrime, të bëjnë një rishikim të kujdesshëm të transkripteve për të siguruar zbatimin e plotë të parimit të procesit publik dhe të masave mbrojtëse në fuqi, si dhe që propozimet e tyre të jenë përputhëse si brenda një transkripti, ashtu edhe në të gjitha transkriptet. Gjithashtu, palët dhe Zyra

⁵¹ Vendimi mbi Konferencat Përgatitore për Gjykimin, para. 31.

⁵² Kur pjesët e transkripteve kanë të bëjnë me rolin dhe funksionimin e Zyrës Administrative, në veçanti të ZMMD-së.

⁵³ Kjo vlen për të gjitha fazat e ardhshme të paraqitjes së provave, pavarësisht nëse janë caktuar në këtë fazë apo jo.

Administrative duhet të sigurojnë të mos kërkojnë të redaktojnë ose të riklasifikojnë si konfidenciale transkripte ose pjesë të tyre që tashmë janë publike.

85. Në rast se palët dhe Zyra Administrative nuk pajtohen për pjesë të veçanta të ndonjë transkripti, duhet ta specifikojnë këtë në parashtrimet e tyre dhe të japin arsyet për mospajtimin e tyre. Në fund, Trupi Gjykses do të vendosë në lidhje me heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve në bazë të rregullave 80(1) dhe 84(1) të Rregullores.

T. KOMUNIKIMI ME TRUPIN GJYKUES

86. Trupi Gjykses thekson se, përveç nëse urdhërohet ndryshe, palët duhet të përfshijnë zyrtarisht në dokumentacionin e lëndës, me anë të parashtrimeve të protokolluara, të gjitha kërkesat, përfshirë ato për zgjatjen e afateve, përgjigjet/kundërpërgjigjet, kundërshtimet, konstatimet dhe njoftimet. Në parim, vetëm aspektet logjistike komunikohen nga palët me anët të mesazheve elektronike përmes NJAGJ-së.⁵⁴

V. VENDIM

87. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** udhëzimet e mësipërme në lidhje me zhvillimin e gjykimit;
- b. **UDHËZON** palët dhe Zyrën Administrative, sipas rastit, të respektojnë afatet e përcaktuara me sipër; dhe
- c. **CAKTON** datat e specifikuara në paragrafin 24 të këtij vendimi si data të bllokut të parë të dëshmive.

⁵⁴ Vendimi mbi Konferencat Përgatitore për Gjykimin, para. 5-6.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E hënë, 11 nëntor 2024

Në Hagë, Holandë.